



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2018:042559  
Datë: 19.10.2018  
Numri i dokumentit: 00150109

P.nr. 653/16

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm**, përmes gjyqtarës Luljete Shabani, në lëndën penale ndaj të akuzuarit A.B. nga ..., për shkak të veprës penale Kanosja, nga neni 185 par.2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, PP. II. Nr.941/16, të datës 24.05.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik, më datën 18.10.2018, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa, më dt. 19.10.2018, përpiloi këtë:

**AKT GJYKIM**

I akuzuari **A.B.**, nga babai Sh. dhe nëna H., e lindur M., i lindur më ...në fsh. ..., K. e ..., jeton në Gjilan, në rr. “...” p.nr. i martuar, baba i gjashtë fëmjëve, pensionist, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i padënuar më parë, nuk udhëhiqet procedurë tjetër penale ndaj tij,

**ËSHTË FAJTOR**

Sepse, më datë 03.05.2016, rreth orës 19.30 min., në lagjen “Dardania I” në Gjilan, pas një mosmarrëveshje të mëhershme rreth një borxhi, e ka kanosur seriozisht të dëmtuarin L.J., edhe atë me anë të fjalëve:” ja keni mi kthy ato pare, ja Xh. dhe F. kanë me ju vra, kam me jau marrë shpijën edhe krejt, ki afat 24 orë, ja kini mi kthy paret, ja keni mu vra krejt, e me ju marrë me shpi e me krejt, unë dhe e boj problemin edhe i marr paret e mija!”, me çka, me veprimet e veta i ka shkaktuar të dëmtuarit ankth, frikë dhe pasiguri për jetë,

- me çka ka kryer veprën penale Kanosja, nga neni 185 par.2 të KPRK, andaj, në bazë të dispozitave të lartcekura ligjore dhe neneve 86, 7,17,21,51,69, 73,114, të KPRK-së, dhe nenit 365, 453 të KPPRK-ës.

:

**VËREJTJE GJYQËSORE**

Ashtu që të akuzuarit A.B., i bëhet me dije se ka kryer një veprë të dëmshme dhe të rrezikshme, që përbën veprë penale për të cilën nëse ai sërish kryen veprë të tillë gjykata do të shqiptojë sanksion më të rëndë penal.

Detyrohet i akuzuari që t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale në shumë prej **15 (pesëmbëdhjetë) €** në emër të paushallit gjyqësor, si dhe shpenzimet tjera sipas llogarisë përfundimtare të kësaj Gjykate, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga data kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Gjilan, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr. 941/16, të dt. 24.05.2016 ndaj të akuzuarit A.B. nga Gjilani, për shkak të veprës penale, Kanosja, nga neni 185 par.2 të KPRK.

Gjyqtarja e vetme gjykuese, pas dëgjimit edhe të Prokurorit të Shtetit konstatoi se janë përmëshur të gjitha kushtet ligjore, nga neni 248 paragrafi 4 të KPPRK për pranimin e fajësisë, ngase i akuzuari e kupton natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, se pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit, si dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Andaj, duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, gjykata e vërtetoi këtë gjendje faktike:

Se i akuzuari A.B., e ka kryer veprën penale Kanosja, nga neni 185 par.2 të KPRK, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Me rastin e shqiptimit të vërejtjes gjyqësore, gjyqtarja e vetme gjykuese, i ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, sipas nenit 86 të KPRK, ku si rrethana lehtësuese, e ka marrë për bazë sjelljen shumë të mirë dhe korrekte të të akuzuarit gjatë mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, se i akuzuari është familjare, baba i gjashtë fëmijëve, se e ka pranuar fajësinë, se ka shprehur keqardhje për kryerjen e kësaj vepre penale, se është hera e parë që ndeshet me ligjin.

Sipas bindjes së kësaj gjykate, shqiptimi i vërejtjes gjyqësore është i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të akuzuarit, si dhe është e mjaftueshme që të arrihet qëllimi i dënimit, ngase vepra penale është kryer në rrethana lehtësuese, të cilat e bëjnë veprën penale veçanërisht të lehtë.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, si dhe paushallin gjyqësor është marrë në bazë të nenit 453 të KPPRK.

Nga të cekurat më lartë, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**  
**Departamenti i përgjithshëm**  
**më 19.10.2018**

**Gjyqtarja e vetme gjykuese,**  
**Luljete Shabani**

**KËSHILLA JURIDIKE** : Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimin të të njejtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate Themelore.